L I G J
Nr.7836, datë 22.6.1994

PËR ÇMIMIN E TOKËS BUJQËSORE PËR EFEKT KOMPENSIMI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton vlerën e tokës bujqësore për efekt të kompensimit në vlerë të ish-pronave personave fizikë e juridikë që përfitojnë nga ligji nr.7699, datë 21.4.1993

KREU II
VLERA E KOMPENSIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

Neni 2

Masa e kompensimit në vlerë për tokën bujqësore përcaktohet mbi bazën e pjellorisë natyrore për një hektar sipas kritereve të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

Për tokat e tjetërsuara dhe ato të pabonituara vlerësimi do të bëhet sipas kritereve që do të përcaktojë Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 3

Vlera e kompensimit të tokës bujqësore, në mbështetje të nenit 2, është si më poshtë:

Vlera në çdo ha në 000/lekë

Klasat	Deri në 15 ha	15 deri në 1000 ha	100 deri në 1100 ha
Klasa I	280	310	360
Klasa II	244	274	324
Klasa III	210	240	290
Klasa IV	171	201	251
Klasa V	135	165	215
Klasa VI	107	137	187
Klasa VII	62	92	142
Klasa VIII deri tek X	50	70	108

Neni 4

Vlerësimi i ullinjve bëhet me rrënjë.

Një rrënjë ulliri për efekt kompensimi vlerësohet me 3000 lekë.

Sipërfaqja e zënë nga çdo rrënjë ulliri llogaritet me 60 m2. Diferenca tjetër e sipërfaqes së tokës që mbetet nga zëri kadastral ullishte, vlerësohet tokë bujqësore.

Neni 5

Për efekt kompensimi në vlerë, në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993, kryhet konvertimi i rrënjëve të pemëve në sipërfaqe toke sipas tabelës përkatëse që i bashkëngjitet këtij ligji.

KREU III
PARAQITJA E PRETENDIMEVE PËR KOMPENSIMIN NË VLERË TË TOKËS BUJQËSORE

Neni 6

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Ky komitet përcakton strukturat kompetente dhe fillon aktivitetin jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë kompetencat e këtij komiteti.

Neni 7

Afati i paraqitjes së dokumenteve që vërtetojnë pronësinë mbi tokën bujqësore të jetë data 30.12.1994.

Për rastet kur vërtetohet se ka patur mosmarrëveshje dhe çështja ka qënë në shqyrtim nga gjykata, dokumentet mund të paraqiten edhe tej këtij afati.

Neni 8

Zyra e kadastrës në rreth vë në dispozicion të strukturave gjithë dokumentacionin që ka për zbatimin e këtij ligji dhe përpilon hartat e pronësisë mbi bazën e dokumentacionit e të pretendimit të ish-pronarëve, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993

Neni 9

Zyra e kadastrës në rreth lëshon vërtetimin për njohjen e ish-pronësisë mbi:

a) bazën e nenit 6 të këtij ligji,

b) kur vërtetohet nga komuna, bashkia ose rrethi në se ka përfituar nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe masën e përfitimit.

c) diferencën në vlerë ndërmjet klasës së tokës që i njihet pronësia dhe asaj që ka marrë.

Neni 10

Personat që në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ndryshuar me ligjin nr.7715, datë 2.6.1993, kanë përfituar tokë, por kanë refuzuar ta marrin, kjo sipërfaqe i zbritet nga masa e sipërfaqes për efekt kompensimi.

Neni 11

Strukturat e kompensimit në vlerë për tokën bujqësore shqyrtojnë pretendimet e paraqitura nga ish-pronarët dhe, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, marrin vendimin përkatës.

Vendimi i komisionit i njoftohet me shkrim personit fizik e juridik të interesuar.

Neni 12

Ish-pronari i tokës bujqësore, të cilit i njihet pronësia nga strukturat kompetente, paraqitet për të marrë obligacionin në degën e thesarit në rreth.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Kundër vendimit të komisionit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit përkatës, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pa shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.883, datë 7.7.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.